

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizrona "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më dat. 27.04.2023	
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-244/A



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000
Prizren, Republika e Kosovës
Tel: +381 (0) 29 232 140
www.uni-prizren.com

RREGULLORE PËR KËRKIME SHKENCORE

Prizren, Prill 2023



Në bazë të dispozitave ligjore të Nenit 42 dhe 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1. të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren (tutje referuar si Universiteti), Senati i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më: 24.04.2023 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR KËRKIME SHKENCORE

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore organizohet puna dhe aktivitetet kërkimore-shkencore, të drejtat dhe detyrimet e organeve kompetente të Universitetit dhe pjesëmarrësve në kërkime shkencore, pjesëmarrja në kongrese dhe konferenca shkencore, punëtori, seminare dhe simpoziume, si pjesë e kërkimeve shkencore të Universitetit.

Organizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore

Neni 2

Personeli akademik dhe studentët e Universitetit realizojnë dhe zbatojnë veprimtarinë kërkimore-shkencore në përputhje me aftësitë e tyre akademike dhe profesionale, si dhe obligimet që dalin nga Plani strategjik i Universitetit, Plani strategjik për kërkime shkencore dhe Planet strategjike të njëjësive akademike. Personeli akademik i Universitetit vlerësohet së paku një herë në vit për performancën dhe kontributin e tij/saj në veprimtarinë kërkimore-shkencore.

Neni 3

Universiteti është i përkushtuar për krijimin e kushteve të përshtatshme infrastrukturore dhe mbështetjen e punës kërkimore-shkencore dhe për të ndihmuar personelin akademik dhe studentët që të arrijë rezultate konkurruese, kërkimore dhe shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 4

Veprimtaria kërkimore-shkencore në Universitet përfshinë:

- 4.1. Kërkimet themelore dhe të aplikuara me qëllim të zhvillimit të kërkimit shkencor në fushat e interesit të Universitetit, të tilla si: Shkencat ekonomike, shkencat juridike, shkencat kompjuterike dhe teknologjisë informatike, të filologjisë, shkencat e agrobiznesit dhe mjedisit, edukim parashkollor dhe fillor, gjuhës dhe letërsisë dhe fushat tjera me interes;
- 4.2. Kërkimet në ndërmarrjet private me qëllim identifikimin e nevojave të tyre për profile specifike të kuadrove;
- 4.3. Organizimin e konferencave shkencore vendore, rajonale dhe ndërkombëtare;
- 4.4. Organizimin e punëtorive dhe seminareve me karakter shkencor dhe profesional;
- 4.5. Bashkëpunimin me institucionet kërkimore vendore dhe ndërkombëtare;



- 4.6. Ofrimin e shërbimeve kërkimore-shkencore dhe profesionale për nevojat e institucioneve qeveritare (Kuvendet Komunale, Ministrinë, Qeverinë e Kosovës etj).
- 4.7. Ofrimin e shërbimeve kërkimore-shkencore dhe profesionale për nevojat e industrisë vendore në bashkëpunim të ngushtë me Bordet Këshilldhënëse Industriale (BKI) të njësive akademike;
- 4.8. Studimet e fizibilitetit, plane biznesore dhe shërbime auditimi për kompanitë private dhe publike,
- 4.9. Ekspertiza dhe superekspertiza në fushat e interesit (gjykata dhe të ngjashme);
- 4.10. Raporte Legal Due Diligence për korporatat multinacionale;
- 4.11. Programe investive dhe programe të tjera profesionale;
- 4.12. Organizimin e seminareve për zhvillimin profesional të personelit akademik në fushat shkencor relevante për Universitetin;
- 4.13. Edukimin e vazhdueshëm profesional (EVP) për personelin akademik;
- 4.14. Veprimtaritë tjera kërkimore-shkencore në fushat e programeve studimore të Universitetit.

Themelimi dhe funksionimi i Qendrës për Kërkime, Inovacion dhe Transfer të Dijes

Neni 5

Me qëllim të zhvillimit të punës kërkimore-shkencore dhe diseminimit të kërkimeve shkencore, Universiteti do të zhvillojë veprimtaritë kërkimore-shkencore në koordinim me:

- 5.1. Qendrën për kërkime, inovacion dhe transfer të dijes në nivel të Universitetit,
- 5.2. Njësitë/departamentet e kërkimit shkencor në nivel të programeve shkencore dhe njësive akademike.
- 5.3. Zyrat dhe komisionet tjera funksionale (Zyra për kërkime shkencore; Zyra për projekte; Këshilli i etikës për kërkime shkencore; etj)

Neni 6

Qendra për kërkime, inovacion dhe transfer të dijes organizon kërkime themelore dhe të aplikuara në përputhje me nevojat e Universitetit, komunitetit biznesor, industrial, qeveritar si dhe palët tjera të interesit.

Neni 7

Qendra për kërkime, inovacion dhe transfer të dijes dhe njësitë/departamentet e kërkimit shkencor, janë përgjegjës për:



- 7.1. Udhëheqjen e aktiviteteve të kërkimore-shkencore në nivel të Universitetit dhe njësive akademike, në përputhje me misionin dhe Planin strategjik të Universitetit;
- 7.2. Hartimin e planit vjetor për punë kërkimore-shkencore duke përfshirë edhe propozimin për buxhetin vjetor për punë kërkimore-shkencore në nivel të Universitetit dhe njësive akademike;
- 7.3. Pagesat për kompensimin e punëve të realizuara, shërbimeve dhe furnizimit me materiale dhe mjete pune për palët e përfshira në punët kërkimore-shkencore;
- 7.4. Zhvillimin e sistemit të evidentimit dhe arkivimit të dokumentacionit që ndërlidhet me aktivitetin e Qendrës për Kërkime, Inovacion dhe Transfer të Dijes dhe njësitë/departamentet e kërkimit shkencor;
- 7.5. Evidentimin në mënyrë kronologjike të dokumentacionit të Qendrës për kërkime, inovacion dhe transfer të dijes në një sistem të integruar enkas për nevojat e Qendrës;
- 7.6. Përditësimin e regjistrit për evidentimin e pasurisë së Qendrës për kërkime, inovacion dhe transfer të dijes dhe të bëjë një herë në vit inventarizimin e pasurisë;
- 7.7. Raportimin e udhëheqësit/koordinatorit të Qendrës për kërkime, inovacion dhe transfer të dijes në Këshill Drejtues, Senat dhe Këshillin Shkencor të Universitetit, lidhur me aktivitetet kërkimore-shkencore,

Neni 8

- 8.1. Organizimi dhe funksionalizimi i Qendrës për Kërkime, Inovacion dhe Transfer të Dijes dhe Njësive/departamenteve të kërkimit shkencor në nivel të programeve shkencore dhe njësive akademike, definohet me Rregullore të veçantë.

Themelimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Shkencor

Neni 9

- 9.1. Këshilli Shkencor i Universitetit themelohet me vendim të Senatit të Universitetit, me përbërjen si në vijim:
 - a) Prorektor/i/ja për mësimdhënie, çështje të studentëve dhe kërkime shkencore;
 - b) Nga një anëtarë përfaqësues i secilës njësi akademike, personel akademik me përvojë të dëshmuar në punën kërkimore-shkencore, të propozuar nga Rektori në konsultim me Këshillin e njësive akademike/Dekanin;
 - c) Udhëheqësi/koordinatori i Qendrës për Kërkime, Inovacion dhe Transfer të Dijes(ex-officio),
 - d) Udhëheqësi i zyrës për kërkime shkencore (ex-officio, pa të drejtë vote)
 - e) Një përfaqësues i studentëve, i propozuar nga Parlamenti Studentor, dhe
 - f) Një këshilltar i jashtëm, i propozuar nga Bordi Këshilldhënës Industrial i njësive akademike të Universitetit.



-
- 9.2. Puna dhe funksionimi i Këshilli Shkencor bazohet në dispozitat e Statutit të Universitetit dhe rregulloret e veçanta.
- 9.3. Këshilli Shkencor verifikon dhe kontrollon përputhshmërinë e të arriturave të kërkimit shkencore të personelit akademik në bazën e të dhënave për punën kërkimore-shkencore.
- 9.4. Harton dhe propozon politikat e zhvillimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore në Universitet.
- 9.5. Këshilli Shkencor organizon mbledhje më së paku gjashtë (6) herë në vit ose më shumë, varësisht nga nevojat e Universitetit.
- 9.5.1. Mbledhjet e Këshillit Shkencor realizohet sipas rendit të ditës së përgatitur nga Prorektor/i/ja për mësimdhënie, çështje të studentëve dhe kërkime shkencore.
- 9.5.2. Prorektor/i/ja për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Kërkime Shkencore përcakton personin përgjegjës të administratës së Universitetit, për mbajtjen dhe hartimin e procesverbalit të mbledhjeve të Këshillit Shkencor.
- 9.6. Këshilli Shkencor diskuton dhe miraton kërkesat dhe propozimet për organizimin ose bashkëorganizimin e kongreseve, konferencave shkencore, punëtorive dhe seminareve në nivel të Universitetit.

Politikat dhe masat nxitëse të mbështetjes financiare për kërkime shkencore

Neni 10

- 10.1. Në funksion të ndërtimit të politikave nxitëse që synojnë rritjen e konkurrencës, vizibilitetit dhe avancimit në rangimin ndërkombëtar të Universitetit, personelit akademik i ofrohet mbështetja financiare lidhur me 5 masa nxitëse të punës kërkimore-shkencore në Universitet:
- 10.1.1. Masa 1: Mbështetje financiare për punime shkencore të botuara në revista shkencore të mbuluara nga platforma Web of Science (Clarivate Analytics);
- 10.1.2. Masa 2: Mbështetje financiare për punime shkencore të botuara në revista shkencore të mbuluara nga platforma Scopus (kuartilet Q1 dhe Q2);
- 10.1.3. Masa 3: Mbështetje financiare për pjesëmarrje në kongrese, konferenca, punëtori dhe Edukim të Vazhdueshëm Professional (EVP).
- 10.1.4. Masa 4: Grante të vogla hulumtuese
- 10.1.5. Masa 5: Përkrahje financiare për nxitje mobiliteti ndërakademik
- 10.2. Për të fituar të drejtën për mbështetje financiare nga Masa 1 dhe 2, personeli akademik që publikon rezultatet e punës kërkimore, duhet të argumentojë me sa vijon:
- 10.2.1. Punime shkencore me tekst të plotë (punime origjinale empirike, rishikim literature etj.) që bartin adresën e Universitetit (affiliations), të botuara në revista shkencore të mbuluara nga Web of Science - Clarivate Analytics (koleksioni bërthamë SCIE, SSCI dhe AHCI). Punimet shkencore të botuara
-



në këtë kategori përfitojnë mbështetjen financiare prej 1,000 EUR (një mijë euro).

- 10.2.2. Punime shkencore me tekst të plotë (punime origjinale empirike, rishikim literature etj.) që bartin adresën e Universitetit (affiliations), të botuara në revista shkencore që nuk mbulohen nga Clarivate Analytics – Web of Science, të indeksuara në Scopus (kuartilet Q1 dhe Q2). Punimet shkencore të botuara në Scopus (kuartili Q1) përfitojnë mbështetjen financiare prej 800 EUR (tetëqind euro), ndërsa punimet shkencore të botuara në Scopus (kuartili Q2) përfitojnë mbështetjen financiare prej 600 EUR (gjashtëqind euro).
 - 10.2.3. Përparsi për përkrahje financiare sipas masës 1 dhe 2 do të kenë publikimet shkencore në bashkautorisi mësimdhënës/student. Me ç'rast edhe studentët përfitojnë mbështetje financiare sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
- 10.3. Për të fituar të drejtën për mbështetje financiare nga Masa 3, personeli akademik që publikon rezultatet e punës kërkimore, duhet të argumentojë me sa vijon:
- 10.3.1. Punime shkencore me tekst të plotë (punime origjinale empirike, rishikim literature etj.) që bartin adresën e Universitetit (affiliations) të botuara në kongrese dhe konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, të aprovuara nga këshillet e fakulteteve dhe senati i Universitetit sipas Nenit 11 pika 11.7.6.
 - 10.3.2. Përparsi për përkrahje financiare sipas masës 3 do të kenë publikimet shkencore në bashkautorisi mësimdhënës/student. Me ç'rast edhe studentët përfitojnë mbështetje financiare sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
- 10.4. Për të fituar të drejtën për mbështetje financiare nga Masa 4, personeli akademik që aplikon për grante hulumtuese duhet të:
- 10.4.1. Paraqes iden e projektit hulumtues i cili duhet të tregojë në detaje qëllimin e hulumtimit, përfitimet e hulumtimit, impakti i hulumtimit në shoqëri dhe ekonominë e vendit, rezultatet e pritshme, detajet lidhur me materialet/pajisjet e nevojshme për hulumtim dhe planin kohorë të realizimit të projektit (të detajuar).
 - 10.4.2. Për t'i arsyetuar parat e fituara duhet në fund të vitit të raportohet rezultati i projektit me grantet e fituara në të kundërtën grant fituesi detyrohet t'i kthej mjetet.
 - 10.4.3. Shuma dhe numri i granteve do të publikohen me rastin e hapjes së thirjes për financim.
- 10.5. Për të fituar të drejtën për mbështetje financiare nga Masa 5, personeli akademik mund të përfitojnë në rast të:
- 10.5.1. Nxitjes së mobiliteteve dhe pjesëmarrjes në hulumtime shkencore në nivel kombëtar dhe regjional.
 - 10.5.2. Vlera e përkrahjes financiare për këtë masë nuk mund të tejkalojë vlerën prej 100 euro.
-



- 10.6. Punimet shkencore që mbështeten financiarisht me Masën 1 dhe 2, duhet të kenë impakt faktor (IF) më të lartë ose të barabartë me 0.3 ($IF \geq 0.3$). Impakt faktori për punimet shkencore në Web of Science i referohet Journal Citation Indicator (JCI), ndërsa për punimet shkencore në Scopus i referohet Scimago Journal Ranking (SJR).
- 10.7. Në varësi të buxhetit të alokuar për mbështetje financiare, Këshilli Drejtues i Universitetit me rekomandim të Këshillit Shkencor, mund të ndryshojë impakt faktorin (IF) e revistave shkencore. Në rast se numri i kërkesave për mbështetje financiare është më i lartë se buxheti i planifikuar i Universitetit, atëherë prioritet i jepet financimit të punimeve shkencore në revista me impact faktor (IF) më të lartë.
- 10.8. Punimet shkencore që përfitojnë mbështetjen financiare duhet të jenë të publikuara nga Shtëpi Botuese jashtë Republikës së Kosovës dhe jashtë vendeve fqinje të Republikës së Kosovës.
- 10.9. Punimet shkencore që botohen në revista dhe shtëpi botuese të dyshimta nuk mbështeten financiarisht nga Universiteti. Kontrolli i revistave shkencore të dyshimta verifikohet në vegëzën: <https://beallslist.net/standalone-journals/>, ndërsa kontrolli për botuesit e rrejshëm verifikohet në vegëzën: <https://beallslist.net/>
- 10.10. Bazuar në informatat relevante, rezervohet e drejta e kontrollit të revistave shkencore dhe shtëpive botuese që mund të kenë histori të verifikueshme në revista/shtëpi botuese të dyshimta. Punimet shkencore të publikuara në këto revista/shtëpi botuese me histori të dyshimtë nuk mund të përfitojnë mbështetje financiare nga Universiteti.
- 10.11. Këshilli shkencor e rezervon të drejtën e refuzimit të kërkesave të parashtruara pas vlerësimit dhe auditimit të detajuar të revistave/shtëpive botuese duke u bazuar informata relevante të hulumtuara dhe faktuara paraprakisht nga Këshilli shkencor.
- 10.12. Personeli akademik duhet të sjell dëshmi se nuk kanë përfituar financiarisht edhe nga Ministrija e Edukimit Shkencës dhe Teknologjisë për të njejtin publikim në revist shkencore ose publikim të prezantuar në konferencë, nëse nuk ka mundësin e sigurimit të dëshmive duhet të bëjë deklarin sipas formularit 3.

Procedura e aplikimit, verifikimit dhe miratimit të kërkesës për mbështetje shkencore

Neni 11

- 11.1. Për të përfituar mbështetjen financiare të paraparë në pikën 10.2 (10.2.1 dhe 10.2.2), personeli akademik duhet t'i drejtohet me kërkesë me shkrim Këshillit Shkencor (Formulari 1).
- 11.2. Këshilli Shkencor e harton raportin e verifikimit dhe kontrollit të vërtetësisë të punimeve shkencore. Ky raport duhet të respektoj kushtet dhe kriteret e parapara në pikën 10.2 (10.2.1, 10.2.2 dhe 10.2.3), 10.6, 10.7, 10.8, 10.9, 10.10, 10.11 dhe 10.12 të kësaj Rregullore (Raporti 1).



- 11.3. Raporti i verifikimit dhe kontrollit të vërtetësisë të punimeve shkencore miratohet periodikisht në mbledhjet e Këshillit Shkencor dhe nënshkruhet nga anëtarët e Këshillit Shkencor.
- 11.4. Në rastet kur një punim shkencor punohet nga dy ose më shumë autorë, të cilët janë personel akademik i Universitetit, atëherë 70% e mbështetjes financiare i takon autorit të parë të punimit shkencor, ndërsa 30% e mbështetjes financiare shpërndahet në mënyrë të barabartë për bashkëautorët tjerë. Nërsa, në rastet kur personeli akademik i Universitetit nuk është autorë i parë i punimit shkencor, atëherë fitojnë të drejtën e vetëm prej 30% të mbështetjes financiare.
- 11.5. Bashkëautorët e punimit shkencor nga universitet tjera (brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës) nuk mund të përfitojnë mbështetje financiare nga Universiteti.
- 11.6. Pas hartimit të raportit të Këshillit Shkencor, të paraparë sipas pikës 11.2 të kësaj Rregulloreje, i njejt i dërgohet në Këshillin Drejtues të Universitetit për miratim.
- 11.6.1. Pas miratimit të Raportit të Këshillit Shkencor nga Këshilli Drejtues, për ekzekutimin e vendimit të Këshillit Drejtues përkujdeset Prorektor/i/ja për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë dhe Zyra e financave e Universitetit.
- 11.6.2. Ekzekutimi i pagesave për përfituesit e mbështetjen financiare të Masës 1 dhe 2, realizohet në fund të vitit fiskal.
- 11.7. Për të fituar të drejtën për mbështetje financiare nga Masa 3, personeli akademik që planifikon pjesëmarrjen dhe prezantimin e punimeve në kongrese ndërkombëtare, konferenca ndërkombëtare, punëtori dhe Edukim të Vazhdueshëm Professional (EVP), duhet të argumentojë me sa vijon:
- 11.7.1. Parashtrimi i kërkesës me arsyetim lidhur me rëndësinë e pjesëmarrjes në kongres/konferencë/punëtori/EVP, dhe miratimi paraprak i kërkesës në Këshillin e njësisë akademike.
- 11.7.2. Parashtrimi i raportit të shpenzimeve të planifikuara të pjesëmarrjes, duke përfshirë taksën e pjesëmarrjes, shpenzimet e akomodimit, shpenzimet e transportit dhe mëditjeve.
- 11.7.3. Propozimin për miratim e kërkesës për pjesëmarrje në kongrese, konferenca dhe EVP paraprakisht e shqyrton dhe miraton/refuzon Prorektor/i/ja për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Kërkime Shkencore, ndërsa vendimin përfundimtar për mbështetje financiare e miraton/refuzon Këshilli Drejtues i Universitetit.
- 11.7.4. Ekzekutimi i pagesave për përfituesit e mbështetjen financiare të Masës 3, realizohet periodikisht pas miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit.
- 11.7.5. Kur studentët janë të përfshirë në hulumtim duhet kërkesës t'i bashkëngjitet dëshmija se është student i rregullt i Universitetit.
- 11.7.6. Këshillat i fakulteteve duhet të propozojnë listën e kongrese dhe konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare apo platformave indeksuese të kongreseve dhe konferencave me interes për fakultetin dhe stafin akademik të cilat duhet të miratohen në Senatin e Universitetit.



-
- 11.8. Për të fituar të drejtën për mbështetje financiare nga Masa 4, personeli akademik që planifikon të aplikojnë për grante të vogla hulumtimi, duhet të argumentojë me sa vijon:
- 11.8.1. Parashtrimi i kërkesës me arsyetim lidhur me rëndësinë e hulumtimit shkencor.
 - 11.8.2. Parashtrimi i raportit për shpenzimet e planifikuara të hulumtimit.
 - 11.8.3. Këshilli Shkencor hap thirrjen publike për grante të vogla së paku një here në vit.
 - 11.8.4. Këshilli Shkencor analizon aplikacionet dhe harton raport për Këshillin Drejtues me propozimet për financim, vendimin përfundimtar merret nga Këshilli Drejtues i Universitetit.
- 11.9. Për të përfituar nga masa 5 stafi akademik duhet të prezantoj ftesën për pjesëmarrje dhe programi i mobilitetit.
- 11.9.1. Propozimin për miratim e kërkesës për masën 5 pjesëmarrje në mobilitet akademik dhe pjesëmarrje në hulumtime shkencore në nivel kombëtar dhe regional paraprakisht e shqyrton dhe miraton/refuzon Prorektor/i/ja për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Kërkime Shkencore, ndërsa vendimin përfundimtar për mbështetje financiare e miraton/refuzon Këshilli Drejtues i Universitetit.
- 11.10. Masat nxitëse për botimet e librave universitar dhe monografite rregullohen me Rregulloren për Shtëpinë Botuese të Universitetit.
- 11.11. Buxheti i Universitetit i paraparë për financimin e punimeve shkencore, sipas nenit 10 të kësaj Rregulloreje, alokohet në proporcion të barabartë për secilën nga 6 njësitë akademike të Universitetit ($1/6 = 16.66\%$).
- 11.12. Të drejtë përfitimi nga masa 1, 2 dhe 3 kanë stafi akademik i cili nuk ka përfituar financiarisht nga ndonjë institucion tjetër vendor. Përfituesit e kësaj mase duhet të nënshkruajnë deklaratën nën betim (formulari 3).
- 11.13. Stafi akademik për Masën 1 dhe 2 përkrahet vetëm me 1 (një) punim në vitë dhe për masën 3 përkrahet vetëm me 1 pjesëmarrje në konferenc në vit.
- 11.14. Për të përfituar mbështetjen financiare të paraparë në pikën 11.7, personeli akademik duhet t'i drejtohet Prorektor/it/es për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Kërkime Shkencore me kërkesë me shkrim (Formulari 2).
- 11.15. Në rast të mosshfrytëzimit të mjeteve të planifikuara të buxhetit nga ndonjëra prej njësisve akademike, atëherë aplikohet mbështetja financiare për njësitë tjera akademike të Universitetit, duke i dhënë prioritet punimeve shkencore (në Masën 1) me impakt faktor (IF) më të lartë.
- 11.16. Mbështetja financiare për Masat 1, 2, 3, 4 dhe 5 realizohet nga kodi buxhetor përkatës në çdo vit fiskal.
- 11.17. Pagesat e mbështetjes financiare realizohet vetëm brenda vitit fiskal, në mënyrë proporcionale sipas kategorisë buxhetore përkatëse, në përputhje me Ligjin për buxhet.
-



11.18. Obligimet financiare në lidhje me mbështetjen financiare duhet të ekzekutohen në vitin fiskal të aplikimit për mbështetje financiare. Nuk lejohet bartja e obligimeve financiare të mbështetjes financiare në vitin vijues fiskal.

Integriteti akademik dhe sjellja etike në punën kërkimore shkencor

Neni 12

12.1. Integriteti akademik nënkupton përkushtimin ndaj vlerave të ndershmërisë, besimit, drejtësisë, respektit, përgjegjësisë, ligjshmërisë dhe shpërndarjes.

12.2. Për të mbështetur integritetin akademik, Universiteti është i përkushtuar për:

12.2.1. Ruajtjen e standardeve më të larta të integritetit të kërkimit shkencor në të gjitha aspektet e kërkimit;

12.2.2. Sigurimin e kritereve se hulumtimi kryhet sipas kornizave, detyrimeve dhe standardeve përkatëse etike, ligjore dhe profesionale;

12.2.3. Mbështetjen e një mjedisi kërkimor të bazuar në një kulturë integriteti, menaxhim të mirë, praktikat më të mira dhe mbështetje institucionale për zhvillimin e personelit akademik dhe studiuesve;

12.2.4. Përdorimin e proceseve transparente, të forta dhe të drejta për t'u marrë me pretendimet e sjelljeve të gabuara të kërkimit shkencor nëse lindin ato;

12.2.5. Puna e përbashkët për të forcuar integritetin e kërkimit shkencor dhe rishikimin e rregullt dhe të hapur të progresit.

12.2.6. Integriteti dhe profesionalizmi nënkupton edhe:

a) Sjelljen në mënyrë etike dhe me përgjegjësi;

b) Saktësinë e rezultateve;

c) Shmangien nga konflikti i interesit;

d) Ruajtjen e dinjitetit, sigurisë, mirëqenies të personave të përfshirë në kërkim.

12.3. Sjellja etike në punën kërkimore-shkencore nënkupton plotësimin e kritereve për përgjegjësi në kërkim shkencor, udhëzon, edukon dhe monitoron kërkuesit shkencorë në respektimin e standardeve etike.

12.4. Sjelljet e papranueshme etike në veprimtarinë kërkimore-shkencore konsiderohet:

12.4.1. Fabrikimi, falsifikimi, mashtrimi: krijimi i të dhënave false ose aspekte të tjera të kërkimit shkencor, përfshirë dokumentacionin dhe pëlqimin e pjesëmarrësve;

12.4.2. Manipulimi i papërshtatshëm ose përzgjedhja e të dhënave, imazheve, citimeve të tjetërkujt, apo ndonjë lloj tjetër i sjelljes mashtruese;

12.4.3. Plagjiatura: Kjo përfshin kopjimin ose shpërdorimin e ideve, teksteve, programeve, ose të dhënave/ rezultateve ose ndonjë kombinim i tyre, pa lejen dhe citimin e duhur. Studiuesit inkurajohen fuqimisht për të rënë dakord paraprakisht me çdo bashkëautor ose kontributdhënës në studim;



-
- 12.4.4. Vetë-plagjiatura (prezantimi i një vepre të botuar më parë sikur të ishte i ri). Kjo konsiderohet sjellje e gabuar në qoftë se kemi të bëjmë me ripërpunim dhe përditësim sipërfaqësor, duke e prezantuar si produkt tërësisht të ri shkencor;
- 12.4.5. Keqprezantimi/keqinterpretimi i të dhënave/rezultateve me ose pa vetëdije, nga pakujdesia ose duke duke paraqitur një interpretim të gabuar të të dhënave;
- 12.4.6. Dyfishim i publikimit, përfshirë kopjimin e pazbuluar gjatë dorëzimit të dorëshkrimeve për botim;
- 12.4.7. Mosdeklarimi i konfliktit të interesit, përfshirë mosdeklarimin e interesave materiale ose të studiuësit ose të financuesve të hulumtimit, përfshirë dështimin për të shpalosur faktin që hulumtimi është i financuar nga ndonjë subjekt;
- 12.4.8. Prezantim i gabuar/rrejshëm i kualifikimeve apo i përvojës shkencore;
- 12.4.9. Keqprezantim i përfshirjes autoriale, siç janë pretendimet e papërshtatshme për autorësinë ose mohimi i autorësisë apo kontributit.

Transparenca dhe barazia e ndarjes së fondeve të mbështetjes financiare

Neni 13

- 13.1. Këshilli Drejtues, çdo vit, publikon listën përfundimtare të përfituesve nga mbështetja financiare.
- 13.2. Lista përfundimtare e përfituesve duhet të përmbajë: emrin e përfituesit, fushën apo aktivitetin e financuar dhe shumat e ndara.
- 13.3. Publikimi i përfituesve të mbështjes financiare bëhet në ueb faqen e Universitetit.

Organizimi dhe bashkëorganizimi i konferencave shkencore

Neni 14

- 14.1. Personeli akademik i Universitetit inkurajohet të organizoj/bashkëorganizoj konferenca, kongrese, punëtori apo seminare me karakter kërkimorë dhe shkencor. Universitetit do të mbështes organizimin e konferencave, kongreseve, punëtorive apo seminareve, duke ofruar:
- 14.1.1. Infrastrukturën brenda kampusit të Universitetit; dhe
- 14.1.2. Mbështetjen financiare për mbarëvajtjen e këtyre aktiviteteve shkencore.
- 14.2. Përfaqësuesit e studentëve, me përkrahjen e menaxhmentit dhe personelit akademik, së paku një (1) herë në vit organizon Konferencën Shkencore Studentore. Kjo konferencë organizohet çdo vit në periudhën Maj/Qershor dhe se e njejta do të organizohet në nivel të çdo njësie akademike.
- 14.3. Universitetit do të mbështes organizimin e Konferencës Shkencore Studentore, duke:
-



- 14.3.1. Planifikuar buxhetin për mbështetjen financiare për organizimin e Konferencës Shkencore Studentore;
- 14.3.2. Ofruar infrastrukturën brenda kampusit të Universitetit; dhe
- 14.3.3. Ofruar mbështetjen akademike, administrative dhe teknike.

Planifikimi financiar i përmbushjes objektive të punës kërkimore-shkencore

Neni 15

15.1. Për përmbushjen e detyrave dhe obligimeve të kësaj Rregulloreje obligohet Prorektor/i/ja për buxhet, financa dhe infrastrukturë që të planifikoj:

15.1.1. Ndarjet buxhetore vjetore të Universitetit; dhe

15.1.2. Ndarjet buxhetore në Kornizën afatmesme të planifikimit financiar të Universitetit.

Hartimi i raportit vjetor të punës kërkimore-shkencore në Universitet

Neni 16

16.1. Prorektor/i/ja për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Kërkime Shkencore, në bashkëpunim me Këshillin Shkencor/Zyrën për kërkime shkencore, harton dhe publikon raportin vjetor të punës kërkimore-shkencore në Universitet.

16.2. Ky raport duhet të përmbledh punimet shkencore dhe kërkimore dhe aktivitetet tjera shkencore të njësive akademike dhe personelit akademik të rregullt të Universitetit.

16.3. Obligohen njësitë akademike që të hartojnë planet vjetore të detajuara për punën kërkimore-shkencore, si dhe planin buxhetor për realizimin e tyre. Njësitë akademike obligohen që të hartojnë një raport mbi punimet shkencore dhe kërkimore dhe aktivitetet tjera shkencore të njësisë akademike.

Hyrja në fuqi, ndryshimi dhe zbatimi

Neni 17

17.1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati i Universitetit.

17.2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet Rregullorja për kërkime shkencore me nr. prot. 01-59/A të datës 15.02.2022.

17.3. Kjo rregullore mund të plotësohet dhe ndryshohet me kërkesën e Rektorit dhe miratim nga Senati i Universitetit.

Kryesuesi i Senatit

Prof. Asoc. Dr. Samedia Krrabaj





KËRKESË PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË PUBLIKIMIT SHKENCOR (Formulari 1)

1. PARASHTRUESI I KËRKESËS:

EMRI DHE MBIEMRI: _____ THIRRJA SHKENCORE: _____
NJËSIA AKADEMIKE: _____ THIRRJA AKADEMIKE: _____
AUTOR KRYESOR: _____
AUTOR KORRESPONDENT: _____
BASHKËAUTORËT: _____

2. DETAJET E PUBLIKIMIT:

PËRKATËSIA E AUTORIT: _____
TITULLI I PUNIMIT: _____
DOI: _____
EMRI I REVISTËS: _____
SHTËPIA BOTUESE: _____
INDEKSIMI NË PLATFORMËN: _____
IMPAKT FAKTORI (IF): _____ WOS ose SCOPUS (Q1-Q2): _____ IF: _____
DATA E PRANIMIT: _____ DATA E PUBLIKIMIT: _____
LINKU I PUBLIKIMIT: _____

3. PREZANTIMI NË NJËSINË AKADEMIKE (BASHKËNGJIT DËSHMINË):

ËSHTË PREZANTUAR SI AKTIVITET NË:

	PO	JO
KONFERENCË	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
NJËSINË AKADEMIKE	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

NESE PO, SQARO MËNYRËN E PREZANTIMIT:

4. RAPORT NGA DEKANI APO UDHËHEQËSIT E NJËSISË AKADEMIKE:

Shënimi: kjo pjesë duhet të mbështetet me një letër që shpjegon përfitimin shkencor nga publikimi i punimit shkencor për Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren dhe duhet t'i paraqitet rektoratit nga nivelet e larta të njësive akademike, siç janë dekanët e fakulteteve ose udhëheqësit e departamenteve.



5. INFORMATA NËSE PUNIMI ËSHTË PREZANTUAR NË KONFERENCË/SIMPOZIUME (NËSE APLIKOHET):

Shëno detajet e organizimit të konferencës apo simpoziumit:

LINKU

I

KONFERENCËS:

VENDI I KONFERENCËS: _____

DATA: _____

6. TË DHËNAT BANKARE TË PËRFITUESIT – AUTORIT TË PARË OSE AUTORIT KORRESPONDENT:

EMRI DHE MBIEMRI I

APLIKANTIT: _____

EMRI I BANKËS: _____

NUMRI I LLOGARISË BANKARE: _____

SWIFT KODI: _____

VENDI: _____

SHUMA E KËRKUAR: _____

SHËNO ME

FJALË: _____

7. PARASHTRUESI I KËRKESËS:

EMRI DHE MBIEMRI: _____

NËNSHKRIMI: _____

DATA DHE VENDI: _____

PLOTËSOHET NGA ZYRTARI I KËSHILLIT SHKENCOR

8. SHQYRTIMI I KËRKESËS:

DATA E PRANIMIT NË ZKSH: _____

ZYRTARI I PRANIMIT: _____

KONTROLLI I

DOKUMENTACIONIT:

I KOMPLETUAR

PAKOMPLETUAR

NËNSHKRIMI: _____

DATA: _____

Kujdes: Plotësimi i të gjitha fushave është i obligueshëm në të kundërtën nuk do shqyrtohet kërkesa!



**FORMULAR I APLIKIMIT PËR FINANÇIM TË PJESËMARRJES NË
KONGRES/KONFERENCË/PUNËTORI/EDUKIM TË VAZHDUESHËM
PROFESSIONAL (EVP)
(Formulari 2)**

1. PARASHTRUESI I KËRKESËS:

EMRI DHE MBIEMRI: _____ THIRRJA SHKENCORE: _____
NJËSIA AKADEMIKE: _____ THIRRJA AKADEMIKE: _____
AUTOR KRYESOR: _____
BASHKËPJESËMARRËSI: _____

**2. DETAJET E KONGRESIT, KONFERENCËS, PUNËTORI OSE EDUKIMIT TË
VAZHDUESHËM PROFESSIONAL (EVP):**

EMËRTIMI I NGJARJES: _____
VENDI DHE DATA: _____
ORGANIZATORI: _____
FTESA DHE PROGRAMI: _____
TITULLI I PUNIMIT: _____

KONFIRMIMI I PRANIMIT TË _____
PUNIMIT: _____
AUTORËT E PUNIMIT
(AFFILIATION): _____
FOLES ME KUMTESË/POSTER: _____
KRYESUES/PANELIST: _____

LINKU I PUBLIKIMIT TË NGJARJES: _____

**3. PËRSHKRIMI I RENDËSISË SË PJESËMARRJES DHE PËRFITIMI PËR
UNIVERSITETIN:**

Duhet të përdoret madhësia e shkronjave 12 (Times new roman) me 1.5 hapësira të rreshtave.



5. RAPORT NGA DEKANI APO UDHËHEQËSIT E DEPARTAMENTEVE/KATEDRAVE NË NJËSINË AKADEMIKE:

Shënimi: kjo pjesë duhet të mbështetet me një letër që shpjegon përfitimën shkencor nga pjesëmarrja për Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren dhe duhet t'i paraqitet rektoratit nga nivelet e larta të njësive akademike, siç janë dekanët e fakulteteve ose udhëheqësit e departamenteve.

6. TË DHËNAT BANKARE TË PËRFITUESIT – PJESËMARRËSIT:

EMRI DHE MBIEMRI I

APLIKANTIT: _____

EMRI I BANKËS: _____

NUMRI I LLOGARISË BANKARE: _____

SWIFT KODI: _____

VENDI: _____

SHUMA E KËRKUAR: _____

ME FJALË: _____

7. PARASHTRUESI I KËRKESËS:

EMRI DHE MBIEMRI: _____

NËNSHKRIMI: _____

DATA DHE VENDI: _____

PLOTËSOHET NGA ZYRTARI I KËSHILLIT SHKENCOR

8. SHQYRTIMI I KËRKESËS:

DATA E PRANIMIT NË ZKSH: _____

ZYRTARI I PRANIMIT: _____

KONTROLLI I

DOKUMENTACIONIT:

I KOMPLETUAR

PAKOMPLETUAR

NËNSHKRIMI: _____

DATA: _____

Kujdes: Plotësimi i të gjitha fushave është i obligueshëm në të kundërtën nuk do shqyrtohet kërkesa!



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN
KËSHILLI SHKENCOR
(Formulari 3)

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

DEKLARATA NËN BETIM

Unë ----- deklaroj nën betim me përgjegjësi etike, morale dhe disiplinore se për këtë punim për të cilin po aplikoj për mbështetje financiare pranë këshillit shkencor në Universitetin "UKSHIN HOTI" në Prizren, nuk jam mbështetur financiarisht nga ndonjë institucion tjetër.

Nënshkrimi.....



RAPORTI I VERIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË PUNIMEVE SHKENCORE

Nr.	Autorët e punimit	Titulli i punimit shkencor	Titulli i revistës shkencore / Botuesi	Indeksuar në Web of Science (WoS) ose Scopus	Impakt faktori (IF)	Shtëpia botuese jashtë vendeve fqinje të Kosovës?	Revista shkencore / botuesi i dyshimtë?		Deklarata Formulari 3	Rekoma ndimi i Këshillit Shkencor
							Revista shkencore	Botuesi		
1.										
2.										
3.										

Anëtarët e Këshillit Shkencor:

Prof. Ass. Dr. Emri dhe mbiemri _____, Prorektor/i/ja për mësimdhënie, çështje të studentëve dhe kërkime shkencore
 Prof. Ass. Dr. Emri dhe mbiemri _____, Anëtar, përfaqësues i Fakultetit të Shkencave Kompiuterike
 Prof. Ass. Dr. Emri dhe mbiemri _____, Anëtar, përfaqësues i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit
 Prof. Ass. Dr. Emri dhe mbiemri _____, Anëtar, përfaqësues i Fakultetit Juridik
 Prof. Ass. Dr. Emri dhe mbiemri _____, Anëtar, përfaqësues i Fakultetit Ekonomik
 Prof. Ass. Dr. Emri dhe mbiemri _____, Anëtar, përfaqësues i Fakultetit të Edukimit
 Prof. Ass. Dr. Emri dhe mbiemri _____, Anëtar, përfaqësues i Fakultetit të Filologjisë
 Emri dhe mbiemri _____, Udhëheqësi/kordinatori i Qendrës për kërkime, inovacion dhe transfer të dijes
 Emri dhe mbiemri _____, Anëtar, përfaqësues i Parlamentit Studentor
 Emri dhe mbiemri _____, Këshilltar i jashtëm, përfaqësues i Bordit Këshilldhënës Industrial (BKI)